



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0168

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani, duke vendosur sipas ankesës së (OE) “Quality Asphalt” SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “KOMUNA E GJAKOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale” me numër të prokurimit 632-23-5381-5-2-1, me 31/05/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Quality Asphalt” SH.P.K. me nr. 2024/0168 , e datës 26/02/2024, kundër Vendimit të autoritetit kontraktues- Komuna e Gjakovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale” me numër të prokurimit; 632-23-5381-5-2-1.
2. Mbetet ne fuqi “Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues” i datës, 07.02.2024 - Komuna e Gjakovës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale” me numër të prokurimit; 632-23-5381-5-2-1.
3. Meqenëse ankesa e OE ankues “Quality Asphalt” SH.P.K, aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 31.05.2023, Komuna e Gjakovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale” me nr. të prokurimit: 632-23-5381-5-2-1. Ndërsa me datën 07.02.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me te cilin ka shpërblyer me kontratë OE " FORTESA SHPK ALBAPROJECT SH.P.K, N.P

Auremont,”

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: - Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 300,000.00 €.

Me 12.02.2024, OE “Quality Asphalt” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 15.02.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën si të bazuar.

Me 26.02.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Quality Asphalt” SH.P.K me nr. 2024/0168 për lidhur me aktivitetin “Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale” me nr. të prokurimit: 632-23-5381-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Quality Asphalt” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi ankimor nr. 1: “Lidhur me Bachelorin e Hidroteknikes z. Astrit Salihu, nuk i ka pasur kontributet e paguara për vitin 2022, ky arsyetim nuk qëndron sepse askund ne kriter te dosjes nuk është kërkuar qe inxhinieri duhet t’i këtë kontributet pensionale te paguara.”

Pretendimi ankimor nr. 2: “Lidhur me pajisjen Eskavator Liebherr A904 HD SL, ne dosjen tone kjo pajisje i plotëson kriteret e DT-se.”

Pretendimi ankimor nr. 3: “AK te GOE i rekomanduar ka bere shkeljen e nenit 26.6 te Rregullores se prokurimit publik nr.01/2022 për arsye se nuk i kane certifikatat te gjithë anëtarët e grupit, por vetëm njeri nga anëtarët e grupit e ka këtë certifikatë.”

Pretendimi ankimor nr. 4: “Po ashtu, GOE i rekomanduar ka çmime jo normalisht te larta, e qe këto çmime duhet te vërtetohen nga ana e Autoritetit Kontraktues, pasi qe shume qarte e thotë edhe Rregullorja 01/2022 për Prokurim Publik.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Quality Asphalt” SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 56.3, 69, 72, 61 dhe 108/A të LPP-së, si dhe 26.6 001/2022.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim:

“Quality Asphalt” SH.P.K “Grup i Operatoreve Ekonomik Quality Asphalt SH.P.K.; CAPITAL X FET SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM, me cit. 12.02.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale”, Nr. i prokurimit- NT. i prokurimit- 63223-5381-5-2-1, i brendshëm-632-23-070 -521. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me date 15.02.2024. ka shqyrtuar kërkesën ne fjalë si me poshtë. Pretendimi juaj lidhur me ing.hidroteknikës Astrit Salihu, Se nuk është kërkuar ne FDT që të ketë kontributet e paguara dhe ky nuk mund të jetë shkak për diskualifikim, nuk qëndron, Sepse në kontratën e punës të cilën e keni lidhur me Astrit Salihu. dhe nenin 19 te kontratës thuhet se punëdhënësi obligohet që të bej pagesën e kontributeve të punësuarit, prandaj mos pagesa e kontributeve si dhe mos figurimi i tij ne listën e ATK-së, e vë ne dyshim vërtetësinë e kontrate (e Cila kërkohej si dëshmi në FDT); Pretendimi juaj lidhur me ekskavatorin Liebherr A904 HD.SL, nuk qëndron, sepse pavarësisht asaj që ju jeni rekomanduar njëherë

për kontratë , gjatë ri-vlerësimit; komisioni gjatë shikimit të katalogëve ka vërejtur se ekskavatori në fjalë nuk e kalon peshën prej 17 ton, me çka nuk plotëson kërkesën e autoriteti kontraktues në FDT-ë; Pretendimi juaj lidhur me [SO Certifikatat nuk qëndron, Sepse kërkesa e Autoritetit kontraktues për këtë pike Është tek "Kërkesat rrebi mundësitë teknike dhe/ose profesionale", dhe nuk është kërkuar që secili anëtarët i grupit të dëshmojë se pëmbushin standardet përkatëse; Pretendimi juaj lidhur me çmimet, nuk qëndron, Sepse të gjithë Operatorët ekonomik që kanë Ofertuar duke ju përfshirë edhe juve, kanë pasur laramani çmimeve pozicione.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 01.03.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 00168/24, ndërsa me datë 29.03.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0168 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet pjesërisht e bazuar vetëm për pretendimi ankimor nr. 2, ndërsa rekomandoj që të mbetet në fuqi vendimi Autoriteti kontraktues Komuna Gjakovës, Njoftimi për dhënien e kontratës.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje në raportin e ekspertit shqyrtues.

Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 01.03.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 00168/24, ndërsa me datë 29.03.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0168 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet pjesërisht e bazuar vetëm për pretendimi ankimor nr. 2, ndërsa rekomandoj që të mbetet në fuqi vendimi Autoriteti kontraktues Komuna Gjakovës, Njoftimi për dhënien e kontratës.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje në raportin e ekspertit shqyrtues.

-Vlerësimi i pretendimit ankimor të OE Quality Asphalt” SH.P.K - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0168 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: OE ankues me datë 12.02.2024 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim në AK. Me datë 15.02.2024 AK ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Përgjigjja e Ekspertit në pretendimin ankimor nr. 1: “Lidhur me pretendimin ankimor sa i përket inxhinierit Astrit Salihu, eksperti shqyrtues sqaron se GOE ANKUES Quality Asphalt SH.P.K; CAPITAL X FET SH.P.K; N.N.SH WORLD MEDIUM ka prezantuar kontratë të rregullt me inxhinierin Astrit Salihu dhe në këtë rast sipas nenit 19 të kontratës punëdhënësi është i obliguar të paguaj kontributet për skemat pensionale të obligueshme dhe skemat tjera të percaktuar me ligj. Nëse GOE ANKUES Quality Asphalt SH.P.K; CAPITAL X FET SH.P.K; N.N.SH WORLD MEDIUM sikur të kishte paraqitur inxhinierin me kontratë për nevojat të veçanta duke angazhuar për këtë projekt, nuk kishte qenë e nevojshme dëshmia lidhur me pagesat e kontributeve pensionale dhe deklarimeve në ATK, dhe si i tillë ky pretendim ankimor është i pa bazuar.”

Përgjigjja e Ekspertit në pretendimin ankimor nr. 2: “Eksperti shqyrtues në lidhje me kërkesën e FDT-se sa i përket makinerisë, Anex 7, Eskavatorr Liebherr A904 HDL, ju sqarojmë se ky pretendim ankimor është i bazuar për faktin se bazuar në dokumentacionin e ofruar përmes e-prokurimit GOE ankues ka ofruar Dudin doganor në lidhje me këtë pajisje me peshe 20 ton dhe e njëjta sipas të gjitha katalogëve dhe

numrit të shasis është eskavator me goma dhe jo me zingjir siç pretendon AK, që dëshmon se e njëjta e plotëson kërkesën e AK-se të vendosur FDT-se, dhe Anex 7.”

Përgjigjja e Ekspertit në pretendimin ankimor Nr. 3: “Lidhur me pretendimin ankimor sa i përket certifikatat për sigurimin e cilësisë, Eksperti sqaron se ky pretendim është i pa bazuar sepse në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë kjo kërkesë bene pjesë të neni 69 Kërkesat mbi mundësin teknike/dhe ose dhe profesionale, dhe bazuar në nenin 71 paragrafi 4 I LPP-se thuhet: Nëse një tender dorëzohet nga një grupi operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është ipërkashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas neni 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

Përgjigjja Ekspertit në pretendimin ankimor nr. 4: “Lidhur me pretendimin ankimor sa i përket se GOE ka çmime jo normalisht të larte, Eksperti sqaron se pretendimi ankimor është i pa bazuar, dhe në këtë rast ju sqarojmë se kompetent për vlerësimin e çmimit të OE ofertues në bazë të neni 61 të LPP-se dhe neni 4.1 i Rregullores 01/2022 Për Prokurim Publik është vet AK-ja.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të neni 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e neni 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale të tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të neni 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Quality Asphalt” SH.P.K Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Quality Asphalt” SH.P.K janë pjesërisht të bazuara.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e raportit të ekspertit shqyrtues vlerësimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e operatorit ekonomik "Quality Asphalt" SH.P.K. të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale" me nr. të prokurimit: 632-23-5381-5-2-1 të mbetet në fuqi vendimi i AK. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuar. Përfundimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues –Komuna e Gjakovës të dates, 07.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale" me nr. të prokurimit: 632-23-5381-5-2-1, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Paneli shqyrtues duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjellojë sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje lidhur me pohimet ankimore, prandaj Paneli shqyrtues mbështet vlerësimet dhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të përsëritshëm të ankesës të "Quality Asphalt" SH.P.K., vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - " Quality Asphalt " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: